

Ligjëratë nga lënda:

Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne

Përmbledhje ligjërate IX

Paraja dhe biznesi

- Çdo shtet përdor monedhen e vet. Këto monedha nuk kanë asnjë vlerë në vetvete, por varen nga besimi i njerëzve se ato mund të shkëmbehen me mallra e shërbime të ardhme.
- Ari e argjendi dikur përdoreshin si monedha botërore që kishin vlerë në vende të ndryshme. Sistemi i sotëm është më abstrakt: monedhat kombëtare vlerësohen kundrejt njëra-tjetrës nëpërmjet kursit të shkëmbimit.
- Monedhat më të rëndësishme, kundrejt të cilave krahasohen pjesa më e madhe e monedhave të shteteve janë: Dollari amerikan, Euro, Jeni japonez.
- Inflacioni, i cili në pjesën më të madhe të rasteve shkaktohet nga shtypja e parave më shpejtë se sa krijimi i prodhimeve e shërbimeve të reja, bën që vlera e monedhës të bjerë në krahasim me monedhat e tjera. Përqindjet e inflacionit ndryshojnë gjërësisht, por përgjithësisht janë shumë më të larta në vendet e botës së tretë dhe ish-blokun sovjetik se sa në perëndimin e industrializuar.
- Shtetet mbajnë rezerva në monedhë të fortë dhe në ar. Këto rezerva mbështesin një monedhë kombëtare dhe mbulojnë mungesat afatshkurtëra të baraspeshës në lëvizjet financiare ndërkombëtare.
- Kurset e palëvizshme të shkëmbimit mund të përdoren për të përcaktuar vlerën e krahasuar të monedhave, por më shpesh shtetet përdorin kurset e lira të shkëmbimit që nxiten nga oferta dhe kërkesa në tregjet botërore të monedhës.
- Qeveritë bashkëpunojnë për të kontrolluar luhatjet e kurseve të shkëmbimit, por janë të kufizuara në këtë përpjekje nga fakti që pjesa më e madhe e parave të shkëmbyera në tregjet botërore është në pronësi private.
- Në vështrim afatgjatë, vlerat e krahasuara të monedhave kombëtare përcaktohen nga gjendja e ekonomive kombëtare dhe e politikave monetare të qeverive (sa para shtypin ose imitojnë ato).
- Qeveritë shpesh parapëlqejnë një vlerë të ulët për monedhën e vendit të tyre, meqenëse kjo gjë nxit eksportet, ul importet dhe si rrjedhojë përmirëson baraspeshën tregtare të shtetit. Megjithatë, një zhvlerësim i njëanshëm i papritur i monedhës është një strategji e rrezikshme, sepse ajo minon besimin te monedha.
- Për të siguruar disiplinë në shtypjen e parasë, e për të shmangur inflacionin, shtetet e industrializuara ua besojnë politikën monetare bankave qendrore gjysëmautonome siç është Federal Reserve e SHBA-së. Duke ua përkushtuar përqindjet e interesit për paratë që qeveria u jep hua bankave private. Një bankë qendrore mund të kontrollojë ofertën e monedhave të një ekonomie kombëtare.
- Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) punojnë me bankat qendrore të shteteve për të ruajtur marrëdhënie monetare ndërkombëtare të qëndrueshme. Prej vitit 1945 deri në vitin 1971, kjo gjë është bërë duke i lidhur monedhat shtetërore me Dollarin Amerikan,

kurse vetë Dollari me arin (mbështetur nga rezervat e arit që mbahen nga qeveria e SHBA-së). Qysh prej asaj kohe, ky sistem ka përdorur në vend të arit, Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes (Special Drawing Rights, ose SDR), që janë një lloj monedhe botërore që kontrollohet nga FMN-ja.

- FMN vë në veprim një system llogaritjeje kombëtare për të mbajtur shënim lëvizjen e parave nga jashtë-brenda e nga brenda-jashtë shteteve. Baraspesha tregtare duhet të rregullohet nëpërmjet lëvizjeve të kapitalit, si dhe të ndryshimit të rezervave monetare.
- Borxhi ndërkombëtar rrjedh prej mungesës së zgjatur të baraspeshës në lëvizjen e kapitalit, domethënë kur një shtet merr më shumë hua se sa jep, me qëllim që të mbulojë një deficit tregtar të vazhdueshëm ose një deficit buxhetor të qeverisë. Si rrjedhojë, vlera e pastër e shtetit që është në borxh zvoglohet dhe pasuria e krijuar drejtohet për pagesën e interesave (dhe pasuria e shtetit huadhënës rritet në përputhje me të).
- Gjendja financiare e SHBA-së ra në mënyrë të natyrshme pas një mbizotërimi të jashtëzakonshëm që kishte menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Rënia e standardit Dollar-Ar në vitin 1971 e pasqyron këtë rënie.
- Në vitet 1980 gjendja e SHBA-së u përkeqësua në mënyrë të jashtëzakonshme. Barra e borxheve të vendit u zgjëtua nga deficit buxhetor i përhershëm dhe nga deficit tregtar. Rritja ekonomike në mesin e viteve 1990 ndihmoi që deficit buxhetor të ulej përsëri.
- Gjendja e Ruisë dhe e shteteve të tjera të ish-blokut sovjetik ka rënë në mënyrë të vrullshme, ndërkohë që këto vende përpiqeshin që të bënin kalimin e vështirë prej komunizmit në kapitalizëm.
- Korporatat shumëkombëshe bëjnë biznes në më shumë se sa një vend në të njejtën kohë. Më të mëdhatë prej tyre mbështeten në shtetet kryesore të industrializuara dhe pjesa më e madhe prej tyre janë private. Korporatat shumëkombëshe po bëhen gjithnjë e më të fuqishme në çështjet ekonomike ndërkombëtare.
- Korporatat shumëkombëshe ndihmojnë në ndërvarësinë ndërkombëtare në shumë mënyra. Shtetet varen nga korporatat shumëkombëshe për krijimin e pasurisë së re, kurse korporatat varen nga shtetet për ruajtjen e qëndrueshmërisë ndërkombëtare, e cila krijon kushtet për të bërë biznes në shkallë ndërkombëtare.
- Investimet e huaja të drejtpërdrejta që bëjnë korporatat shumëkombëshe kërkojnë vite për t'u rikthyer në të ardhura; ndërkohë, korporatat shumëkombëshe nuk mund ti lëvizin lirisht veprimtaritë e tyre prej një shteti ku ato kanë investuar. Qeveritë I kërkojnë të tilla investime të huaja në territoret e tyre, me synimin që të përfitojnë prej të ardhurave që do të krijohen në të ardhmen.
- Korporatat shumëkombëshe mundohen që të n dikojnë mbi politikat ndërkombëtare sit të shteteve ku kanë vendndodhjen e tyre, ashtu edhe të shteteve ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
- Korporatat shumëkombëshe që e kanë vendndodhjen e tyre në shtete të ndryshme po krijojnë gjithnjë e më shumë aleanca ndërkombëtare me njëra-tjetrën. Këto aleanca ndërmjet korporatave, në një shkallë edhe më të madhe se sa veprimtaritë e tjera të korporatave shumëkombëshe që kryhen në shkallë ndërkombëtare, po krijojnë ndërvarësi ndërkombëtare e po nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar liberal.

- Megjithate, korporatat shumëkombëshe ndonjëherë nxisin më shumë nacionalizmin ekonomik se sa liberalizmin, sidomos në rastin e korporatave që janë në pronësi të shtetit ose të aleancave të korporatave shumëkombëshe që veprojnë në një shtet të vetëm.